



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. Regj. Them 3578 31103- 03344-80-2016
 Datë. Regj. 26.04.2016

Datë vendimi 12.05.2016

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS ”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e përbërë prej :

GJYQTARE : SELVIE GJOÇAJ

Asistuar nga sekretare gjyqësore Anisa Zoto, në Tiranë, sot më datë 12.05.2016, mori në shqyrtim në seancë përgatitore çështjen administrative nr. 3578 (31103-03344-80-2016) Akti, që i përket:

PADITES:

1. Anxhela Hoxha e bija e Refailit dhe e Lirise, lindur me 23 Maj1979, ne Tirane dhe banuese ne Tirane, Rr "Hoxha Tasim", P.273, Shk.1, Ap.15
2. Artan Manushaqe i biri i Astritit dhe i Alijes, lindur me 13.06.1980 Çorovode Skrapar, banues ne Tirane, adresa: Rr Teodor Keko (Unaze e Re).
3. Andi Tepelena i biri i Bardhylit dhe i Jetes, lindur ne 1972 ne Tirane dhe banues ne Tirane me adrese: Rr: Elbasanit, "P.Tershana" (mbrapa shkolles se Mesme te Gjuheve te huaja).
4. Brizilda Gjikondi, e bija e Tamares dhe Azbiut, lindur me 28.10.1969, Bukuresht Rumani, banuese ne Tirane Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet "1 Maji", nr.4.
5. Ervin Goci, i biri i Tefikut dhe Violetes, lindur me 27.12.1982, ne Kroje, banues ne Tirane me adrese Rr "Naim Frasheri, Pall.61/7, Shk.3, Ap.24.
6. Eljan Tanini, i biri i Arbenit dhe i Majlindes, lindur me 10 Janar 1988, lindur dhe banues ne Tirane, Rruga e Durresit, Pall.220, Shk.1, Ap.6.
7. Rezarta Çaushaj, e bija e Veisit dhe Ferziletës, lindur ne Vlore ne dt.16.06.1990 dhe banuese ne Tirane, Rr: Dora D'Istria, P.12/1, Shk.1, Ap.7.

Të përfaqësuar në gjykim nga Av. Dorian Matlija Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. Liç 2621, Nipt K81328030G, i caktuar me deklaram ne seancë.

TE PADITUR:

Bashkia e Tiranës, Bulevardi "Deshmoret e Kombit", përfaqësuar në gjykim nga znj. Glenda Zeneli, e caktuar sipas autorizimit nr. 13242/1 prot, datë 03.05.2016.

Këshilli Kombëtar i Territorit, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga znj. Floralda Alimehmeti me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Legjislacionit pranë Agjensisë së Zhvillimit të Territorit, e caktuar sipas autorizimit nr.782 Prot, datë 03.05.2016.

"Star Tek" sh.p.k, me NUIS L22327007, përfaqësuar nga administratori Lulezim Mehmetaj, me adresë: Rr "Tish Dahlja", pallati "Rati", kati I-re, njesia Bashkiake nr.5, Tiranë (ne mungese).

"Riviera" sh.p.k, me NUIS J66903244, përfaqësuar nga administratori i saj, Dritan Cela, me seli Tirane, Rr "Themistokli Germenji" nr.3/2 (ne mungese).

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit z. Elton Hysko.

OBJEKTI:

Sigurimin e padisë duke vendosur pezullimin e lejes së ndertimit dt.03.03.2016, për objektin "Kendi i lojërave për fëmijë, projekti pilot 4, në kuader të rehabilitimit të parkut të liqenit", dhe në zhvilluesit Bashkia Tirane.

Marrjen e masave shtese të sigurimit të padisë, duke vendosur pezullimin e menjehershëm të punimeve dhe veprimeve të Bashkisë Tirane dhe nënkontraktoreve të saj brenda zonës së rëndësishme Kombëtare, Kurora e Gjelber e Tiranës dhe përkatësisht, Zonën Kadastrale nr.8280 me Nr.Pasurie 2/280, Nr.pasurie 2/283 (zona e ndertimit), për Projektin "Kendi i Lojërave për fëmijë" të prokuruar nga Bashkia Tirane.

Konstatimin e pavlefshmerisë absolute të vendimit nr.1, datë 12.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së ndertimit për objektin "Kendi i Lojërave për fëmijë, projekti pilot 4", në kuader të rehabilitimit të parkut të liqenit, Bashkia Tirane.

Konstatimin e pavlefshmerisë së lejes së ndertimit, datë 03.03.2016, të KKT-së të leshuar për zhvilluesin Bashkia Tirane.

Konstatimin e pavlefshmerisë së lejes së ndertimit, datë 03.03.2016, të KKT-së, të leshuar për zhvilluesin Bashkia Tirane, për objektin "Kendi i lojërave për fëmijë, projekti pilot 4, në kuader të rehabilitimit të parkut të liqenit, Bashkia Tirane", bazuar në VKT

nr.1, per zhvillimin e pronave te ndodhura ne zonen Kadastrale nr.8280 me nr.pasurie 2/280, Nr.pasurie 2/281 dhe nr.pasurie 2/283; Shpalljen e pavlefshmerise se procedures se prokurimit me objekt kryerjen e punimeve per "Kendin e Lojerave per femije", per fondin limit prej 67 983 445 leke pa TVSH (Buletini nr.49/2015).

Konstatimin e paligjshmerise se punimeve te ndertimit te zhvilluesit Bashkia e Tiranes, te kryera ne pasurie e ndodhura brenda zones se rendesise Kombetare, Kurora e Gjelber te Tiranes dhe perkatesisht, Zonen Kadastrale nr.8280 me nr.pasurie 2/280, nr.pasurie 2/281 dhe nr.pasurie 2/283 (zona e ndertimit), per projektin "Kendi i Lojerave per femije" te prokuruar nga Bashkia e Tiranes.

Detyrimin e Bashkise se Tiranes per te ndaluar punimet e ndertimit dhe per rikthimin e zones ne gjendjen e meparshme.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 28, 29 dhe 30 te ligji nr.49/2012, date 03.05.2012 "Për Gjykatat Administrative", i ndryshuar; Konventa e Aarhusit per te drejten e publikut per te pasur informacion, per te marre pjese ne vendimarrje dhe per tju drejtuar Gjykates per ceshtje te mjedisit, ratifikuar me ligjin nr.8672/2000; Ligji nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"; Ligji nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; Ligji nr.91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" Ligji nr.10440, date 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit ne mjedis"; K.Pr.Administrative, neni 116; Vendimi i KKT-se, nr.4, date 29.12.2014 "Për përcaktimin e çështjes dhe zones e rendesi kombetare ne planifikimin e territorit, identifikuar si kurora e gjelber e Tiranes"; Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 956, date 29.12.2014 "Për përcaktimin e kurores se gjelber të Tiranes dhe masat për mbrojtjen e saj"; Vendimi i Keshillit të Ministrave nr.408, date 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit".

Në përfundim të hetimit gjyqësor te kërkimit për marrje mase sigurim padie, të zhvilluar, ne prani të paditësave dhe përfaqësuesit te tyre, te përfaqësuesve te paleve të paditura Bashkia Tiranë dhe Këshilli i Rregullimit te Territorit si dhe avokatit të shtetit, ne mungese te paleve te paditura shoqerise "Star Tek" sh.p.k dhe shoqërisë "Riviera" sh.p.k , Gjykata, pasi i degjoi palet prezent, të cilat përfundimisht kërkuan:

Paditësit dhe përfaqësuesi i tyre: Pranimin e kërkesave për marrje mase sigurim padie dhe masave shtese te sigurimit te padise;

Përfaqësueset e palëve të paditura: Rrëzimin e kërkesave, si të pabazuara në ligj dhe ne prova;

Avokati i shtetit: Rrëzimin e kërkesave, si te pabazuara në ligj dhe në prova;

si dhe analizo i rrethanat e çështjes të parashtruara dhe provat e paraqitura deri ne ketë moment,

VËREN SE:

Me datë 15.04.2016 paditësit Anxhela Hoxha, Artan Manushaqe, Andi Tepelena, Brizida Gjikonci, Ervin Goci, Eljan Tanini dhe Rezarta Çaushaj fillimisht i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me një kërkesë padi me objekt: *“Sigurimin e padise duke vendosur pezullimin e lejes se ndertimit dt.03.03.2016, per objektin “Kendi i lojerave per femije, projekti pilot 4, ne kuader te rehabilitimit te parkut te liqenit”, dhene zhvilluesit Bashkia Tirane.Marrjen e masave shtese te sigurimit te padise, duke vendosur pezullimin e menjehershem te punimeve dhe veprimeve te Bashkise Tirane dhe nenkontraktoreve te saj brenda zones se rendesise Kombetare, Kurora e Gjelber e Tiranës dhe perkatesisht, Zonen Kadastrale nr.8280 me Nr.Pasurie 2/280, Nr.pasurie 2/283 (zona e ndertimit), per Projektin “Kendi i Lojerave per femije” te prokuruar nga Bashkia Tirane.Konstatimin e pavlefshmerise absolute te vendimit nr.1, date 12.02.2016 të Keshillit Kombetar te Territorit per miratimin e lejes se ndertimit per objektin “Kendi i Lojerave per femije, projekti pilot 4”, ne kuader te rehabilitimit te parkut te liqenit, Bashkia Tirane.Konstatimin e pavlefshmerise se lejes se ndertimit, date 03.03.2016, te KKT-se te leshuar per zhvilluesin Bashkia Tirane.Konstatimin e pavlefshmerise se lejes se ndertimit, date 03.03.2016, te KKT-se,te leshuar per zhvilluesin Bashkia Tirane, per objektin “Kendi i lojerave per femije, projekti pilot 4, ne kuader te rehabilitimit te parkut te liqenit, Bashkia Tirane”, bazuar ne VKT nr.1, per zhvillimin e pronave te ndodhura ne zonen Kadastrale nr.8280 me nr.pasurie 2/280, Nr.pasurie 2/281 dhe nr.pasurie 2/283; Shpalljen e pavlefshmerise se procedures se prokurimit me objekt kryerjen e punimeve per “Kendin e Lojerave per femije”, per fondin limit prej 67 983 445 leke pa TVSH (Buletini nr.49/2015).Konstatimin e paligjshmerise se punimeve te ndertimit te zhvilluesit Bashkia e Tiranës, te kryera ne pasurie e ndodhura brenda zones se rendesise Kombetare, Kurora e Gjelber te Tiranës dhe perkatesisht, Zonen Kadastrale nr.8280 me nr.pasurie 2/280, nr.pasurie 2/281 dhe nr.pasurie 2/283 (zona e ndertimit), per projektin “Kendi i Lojerave per femije” te prokuruar nga Bashkia e Tiranës.Detyrimin e Bashkise se Tiranës per te ndaluar punimet e ndertimit dhe per rikthimin e zones ne gjendjen e meparshme”.*

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 13, datë 18.04.2016, ka vendosur: *“1.Shpalljen e moskompetences funksionale per shqyrtimin e ketij konflikti. 2. Dergimin e kerkese padise dhe akteve Gjykatës Adminsitrative te Shkalles se Parë Tiranë. 3.Kunder ketij vendimi lejohet ankim se bashku me vendimin perfundimtar”.*

Gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, konstatoi kryesisht se kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe bazuar në nenet 7, 10/1 dhe 11/2 të ligjit nr. 49/ 2012 ‘ Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është kompetente nga pikëpamja lëndore, funksionale dhe tokësore për shqyrtimin gjyqësor të saj.

Bazuar në parashikimet e nenit 12/1 të ligjit nr. 49/ 2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, çështja u mor në shqyrtim nga trup gjykues i përbërë nga një gjyqtar.

Nga njohja me aktet rezultoi që kërkesë padia ka ardhur pranë gjykatës më datë 26.04.2016. Pas hedhjes së shortit dhe vënies ne dispozicion te gjykatës te akteve datë 28.04.2016, duke qenë se pjese e objektit të padisë ishin dhe kerkimet per marrje një mase sigurimi padie dhe marrje masa shtese sigurimi padie, bazuar në parashikimet e nenit 28/3 të ligjit nr. 49/ 2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" brenda afatit 5 ditor, u caktua seanca për marrjen në shqyrtim të këtyre kerkimeve të paditësave. Gjykata njoftoi me fletëthirrje palët sipas kërkesë padisë, në adresat e përcaktuara ne të.

Po kështu, bazuar në parashikimet e nenit 79/a të K.Pr.Civile, kërkesë padia iu komunikua dhe Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, ku ne gjykim u paraqit Avokati i Shtetit z. Elton Hysko.

Nga hetimi gjyqësor i zhvilluar deri ne këtë moment rezulton që :

Me vendimin nr.1, datë 12.02.2016, Këshilli Kombëtar i Territorit ka vendosur "Miratimin e lejes së ndërtimit për objektin "Këndi i Lojrave për Fëmijë, Projekti Pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të Liqenit, Bashkia Tiranë ". Më datë 03.03.2016, Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka nxjerre aktin "Leje ndërtimi", për objektin "Këndi i Lojrave për Fëmijë, Projekti Pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të Liqenit, Bashkia Tiranë", në favor të zhvilluesit Bashkia Tiranë. Nderkohe, me pare Bashkia Tirane ka zhvilluar proceduren e prokurimit publik per perzgjedhjen e subjektit fitues te tenderit per kryerjen e punimeve te Projektit te Parkut te Lojrave, ne perfundim te te cilit ka lidhur dhe kontraten perkatese per realizimin e ketyre punimeve. Paditesit Anxhela Hoxha, Artan Manushaqe, Andi Tepelena, Brizida Gjikonci, Ervin Goci, Eljan Tanini dhe Rezarta Çaushaj, te aktivizuar dhe pjese e aktiviteteve "Nisma per qytetaret", oragnizim i krijuar per mbrojtjen e Parkut te Liqenit nga nderhyrjet e paligjshem te subjekteve private dhe publike, duke pretendnuar se aktet per miratimin e lejes se ndertimit, leja e ndertimit, procedurat e prokurimit etj, jane të pavlefshëme, i jane drejtuar Gjykates me kerkese padien objekt gjykimi, duke kerkuar, nder te tjera, te merret si masë sigurimi e padise pezullimi i lejes se ndertimit datë 03.03.2016, per objektin "Kendi i lojerave per femije, projekti pilot 4, ne kuader te rehabilitimit te parkut te liqenit", dhënë zhvilluesit Bashkia Tiranë dhe si mase shtese pezullimi i menjehershëm i punimeve dhe veprimeve te Bashkise Tirane dhe nenkontraktoreve te saj brenda zones se rendesise Kombetare, Kurora e Gjelber e Tiranës dhe perkatesisht, Zonen Kadastrale nr. 8280 me Nr.Pasurie 2/280, Nr. pasurie 2/283 (zona e ndertimit), per Projektin "Kendi i Lojerave per femije" te prokuruar nga Bashkia Tiranë.

Në lidhje me kërkimin për marrjen e masë së sigurimit të padisë dhe masave shtese per sigurimin e padisë, paditësit dhe perfaqësuesi i tyre parashtruan keto pretendime:

Kjo kërkesë e paditësave bazohet në nenin 28 të ligjit nr. 49/2012, dt 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Në nenin 29 te po ketij Ligji, përcaktohen kriteret se kur vendoset masa e sigurimit të padisë. Ne vijim i anlizojme ekzistencen e ketyre kriterëve ne rastin konkret:

1.1 Ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësit:

1.1.1 Standardi i provës që kërkohet është “dyshimi i arsyeshëm”

Në teorinë e së drejtës, ka disa standarde të provës:

- Dyshimi i arsyeshëm;
- Besimi i arsyeshëm;
- Shkaku i vlefshëm;
- Provat e besueshme;
- Balanca e probabilitetit;
- Prova të qarta dhe bindëse;
- Përtej çdo dyshimi të arsyeshëm;
- Përtej çdo hije dyshimi;

Kjo është një renditje e bërë sipas standardeve nga më i lehti tek më i rëndi. Ndërkohë që tre të parat janë standarde të përdorura për marrjen e masave të sigurisë, i katërti dhe i pesti përdoren gjerësisht në proceset civile dhe administrative, dhe më tej standardet e tjerë përdoren në proceset penale. Vëmë në dukje që për kërkesën konkrete për marrjen e masës së sigurisë vlen standardi i dyshimit të arsyeshëm, i cili është standardi më i ulët i provës për të përcaktuar nëse një masë sigurie është e mbështetur. Është e rëndësishme të theksohet se masa e sigurisë duhet të jetë e kufizuar në kohë dhe në përputhje me fillesën e provave të paraqitura. Masa shërben vetëm për të parandaluar ardhjen e pasojave të rënda dhe të parikthyeshme që mund të ndodhin gjatë kohës së zhvillimit të procesit gjyqësor dhe nuk ka efektë përhershëm. Nëse hetimi gjyqësor konfirmon dyshimin fillestar dhe gjykata pranon padinë, masa e sigurisë kthehet në një masë me efekt të përhershëm. Vlerësimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm duhet thjesht të mbështetet në prova të mjaftueshme aq sa për të dyshuar tek ardhja e një pasojë e mundshme, e cila jo domosdoshmërisht duhet të ndodhë.

1.2 Dyshimi bazohet në shkresa, por jo vetëm:

Paditësit kanë sjellë disa prova shkresore, me anë të të cilave arrin të provohet pretendimi në versionin e tyre të ngjarjeve, duke e bërë këtë version më të arsyeshëm se versioni që jep pala e paditur.

Së pari, provohet se pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka marrë një vendim për të ndërtuar një park lojrash, një projekt pilot, brenda hapësirës së gjelbër të Parkut të Tiranës.

Së dyti, provohet se pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka lidhur një kontratë administrative të prokurimit publik për ndërtimin e projektit. Sipas sistemit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik rezulton se është shpallur formulari i njoftimit të kontratës së lidhur me personin e tretë.

Së treti, provohet se pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka kërkuar miratimin e një leje ndërtimi për këtë punë publike nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Ky organ ka miratuar lejen e ndërtimit me kusht, duke i vendosur kushtin që të plotësohen lejet përkatëse. Mosplotësimi i kushtit bën të pamundur zbardhjen dhe dorëzimin e lejes për të lejuar nisjen e punimeve nga Bashkia Tiranë dhe kontraktorët e saj.

Së katërti, tashmë e bërë publike në çdo media të shkruar apo elektronike, projekti pilot i këndit të lojrave në Parkun e Tiranës ka nisur nga zbatimi, duke prerë pemët dhe duke vijuar me betonizimin e zonës së blertë.

Së pesti, provohet që ky është vetëm një projekt pilot, i cili për nga natyra e tij pritet që të pasohet me projekte të tjera të ngjashëm në të ardhmen afatshkurtër ose afatmesme. Nga sa më sipër, ekzistojnë prova shkencore të mjaftueshme për të bindur gjykatën që në Parkun e Tiranës, një zonë e mbrojtur kjo, janë ndërmarrë veprime administrative të njëpasnjëshme për ta shndërruar një pjesë të kësaj zone në hapësirë të shpyllëzuar dhe të betonuar. Kontrata është lidhur dhe ajo do zbatohet.

1.3. Mundësia e shkaktimit të një dëmi të rëndë dhe të pakthyeshmë

Paraprakisht theksojmë se ligji nuk kërkon vërtetimin përtej cdo dyshimi që do vijë një pasojë e dëmshme dhe e pakthyeshme. Ligji përmban fjalën "mund", që nënkupton se mjafton të ekzistojë mundësia, pavarësisht se në praktikë mund të rezultojë edhe e kundërta. Paditësit kanë bindje të plotë që zbatimi i projektit për ndërtimin e parkut të fëmijëve brenda Parkut të Tiranës gjatë kohës së zhvillimit të këtij procesi gjyqësor ka mjaftueshëm gjasa që të sjellë dëm të rëndë dhe të pakthyeshmë. Këto mundësi nuk përjashtohen sepse:

Së pari, detyrimi i Parkut të Tiranës, ose kthimi i tij nga Park Natyror në Park Urban, nuk do të ketë më rolin shplohës, apo rekreacional, as për të rritur e as për fëmijë, duke qenë një park miks urban. Park natyror quhet ai park, ku pemët nuk janë mbjellë në rresht apo sipas një radhe të caktuar me distanca 3x3 apo 4x4 metra, por pemët janë zhvilluar ose janë mbjellë në mënyrë natyrore sipas një rregulli kaotik apo spontan. Një park natyror është një peizazh i mbrojtur me anë të planifikimit afatgjatë sipas ligjit për mbrojtjen e pyjeve. Këto peisazhe të vlefshme janë ruajtur në gjendjen e tyre aktuale dhe promovohen për qëllime shplohëse. Parku natyror nuk është i njëjtë me një park kombëtar, i cili përcaktohet nga Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës - IUCN. Parku natyror nuk është i njëjtë as me Zonat e Mbrojtura, të cilat mund të bien në kategori të ndryshme të IUCN. Në thelb, të gjitha veprimet apo ndërhyrjet dhe projektet janë në kundërshtim me qëllimin e parkut natyror dhe ndalohen sepse këto zona duhet të jenë veçanërisht të përshtatshme për rekreacion, për shkak të karakteristikave të veçanta të tyre.

Së dyti, betonizimi i Parkut në zemër të tij, në një sipërfaqe prej 12000 m² dhe me një perimetër prej 2000 m, mund të pasohet me:

- Frenim të ujërave nëntokësorë drejt rrënjëve të pemëve;
- Frenim të ujërave shkarkues të tokës drejt liqenit;
- Humbje përfundimtare të pjesës së gjelbëruar.

Betonizimi me mur apo mbulimi me guralecë, bën të mundur që ujërat nëntokësorë të ndalojnë së përshkruari mjedisin nëntokësor, duke mos shkuar në sasinë e duhur drejt rrënjëve të pemëve që do të mbeten, duke shtuar sasinë e prurjeve ujore drejt liqenit (i njohur si procesi run-off) ose shpëlarje e tokës, duke ndryshuar ekuilibrat e formuar në vite të ujërave nëntokësorë. Në këtë mënyrë procesi i betonizimit mund të sjellë humbjen përfundimtare të mundësinë për gjelbërim të mëtejshëm.

Së treti, prerja e pemëve në një Park Natyror prej dhjetëra të tilla deri më tani, e më shumë në vazhdim të zbatimit të projektit, pasohet me ulje të prodhimit të oksigjenit dhe shtim të nivelit të gazit karbonik.

Së katërti, Parku i fëmijëve mund të hapë siparin apo të krijojë mundësinë për betonizimin e mëtejshëm të Parkut të Tiranës me 11 projektet e tjera, të përfshira në atë që ndryshe quhet Park Tematik. Parku Tematik i përbërë nga këto 11 projekte të tjera do

të kërkojë të priten me qindra pemë të tjera dhe efekti progresiv i pasojave të lartpërmendura.

Së pesti, ndryshimi i destinacionit të tokës në këtë zonë do të legjitimojë pronarët e ligjshëm të saj ta përdorin tokën, me pasojë fragmentimin e parkut dhe kthimin e tij në një Park Urban, në mënyrë të parikthyeshme.

Së gjashti, ngritja e një Parku Tematik do të dobësojnë ndikimin pozitiv jetëdhënës të brizës detare që vjen nga veriu (Paskuqani), e cila rrugëton përmes bulevardit të madh, përplasjet në këtë Park dhe kthehet në rolin e 'Kondicionerit natyror', që provohet nga fakti i njohur botërisht, i njohur si trendafil i erërave për Qytetin e Tiranës, e ndërtuar nga Instituti i Gjeoshkencave dhe Hidrometeorologjisë, Tiranë.

1.4. Për të legjitimuar një masë sigurie dëmi mund të jetë i riparueshëm, ose vështirësisht i riparueshëm

Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 32, datë 24.11.2003, edhe në rast se pasojat janë të riparueshme, por ky riparim është i vështirë, situata vlerësohet njëjloj si në rastin e pasojës së riparueshme. Kështu, pas betonizimit dhe prerjes së pemëve, në rast të pranimit eventual të padisë, mund të ekzistojë mundësia që betoni të hiqet dhe pemët të rimbillen. Por, ky proces është shumë i vështirë dhe kërkon një kohëzgjatje shumë të madhe. Është fakt që Bashkia Tiranë nuk ka bërë asnjë njoftim apo konsultim me publikun për ndërhyrjen në këtë zonë të mbrojtur. Është fakt që Konventa e Aarhusit dhe ligji për mjedisin janë shkelur. Është fakt që leja me kusht nuk është plotësuar. Është fakt që tenderi është zhvilluar në mungesë të kushteve thelbësore të mësipërme. Është fakt që Parku i Tiranës gëzon mbrojtje të veçantë. Për të gjitha këto, është tepër e vështirë për paditësit që të besojnë se ky proces administrativ do të cilësohet si i ligjshëm në këtë kontroll gjyqësor. Por, ndërkohë këtij procesi do i duhet disa javë kohë dhe brenda këtyre javëve mund të vijnë pasoja që do të duhen dekada për t'u riparuar. Në këto kushte, në mos jemi përpara një dëmi të riparueshëm, të paktën jemi përpara një dëmi vështirësisht të riparueshëm. Pezullimi disa javë do të kursejë një punë kolosale dhe një humbje të madhe për banorët e Tiranës.

1.5. Ekziston mundësia për dëm të këtëçastshëm

Dëmi potencial i referuar më lart nuk pritet të ndodhë pas shumë kohësh, ose nuk ka ndonjë datë të qartë se kur mund të ndodhë. Përkundrazi, dëmi po ndodh pikërisht në këto momente. Kontrata provohet që është lidhur. Ajo është me afat dhe se veprimet e para janë trafshimi i terrcinit dhe hedhja e masivit të betonit. Më pas do të vijohet me ndërtimin e rifiniturave. Situata është emergjente. Çdo ditë betonierat futen brenda zonës së mbrojtur dhe derdhin metra të tëra kub beton, duke zvogëluar sipërfaqen e blertë. Deri në përfundim të gjykimit kjo sipërfaqe rrezikon të jetë reduktuar ndjeshëm. Është gjithashtu e deklaruar publikisht nga Kryetari i Bashkisë Tiranë që inaugurimi i këtij parku do të bëhet më 1 qershor 2016, si dita e fëmijëve. Pra, nga përfundimi i planifikuar kanë mbetur vetëm 25 ditë. Pas 25 ditëve dëmi do të jetë realizuar i plotë, çka demonstroi se dëmi është iminent.

2. Nuk cenohet rëndë interesi publik

Neni 29 i ligjit nr. 49/2012 nuk kërkon thjesht që të mos cenohet interesi publik, por thekson se ky interes publik nuk duhet cenuar "rëndë". Në këtë kuptim, nëse interesi

publik cenohet lehtë, kjo nuk është e njaftueshme për të mos lejuar marrjen e masës së sigurisë sipas kërkesës së paditësve. Në rastin konkret interesi publik nuk cenohet as rëndë e as lehtë, sepse:

Së pari, objekti i veprimtarisë administrative në fjalë është ndërtimi i një parku lojrash për fëmijë, i cili nuk ka rëndësi jetike, pa të cilin interesi publik do të cenohet rëndë. Nuk jemi përpara ndonjë rasti kur është duke u ndërtuar një urgjencë mjekësore, apo ndonjë stacion zjarëfikësish, apo duke u rikonstruktuar ndonjë komisariat policie, etj. Parku i lojrave për fëmijë, nëse cdo veprim nga ana e Bashkisë Tiranë është në respekt të ligjit, thjesht do të mund të vonohet vetëm disa javë, ose edhe më pak, aq sa zgjat një proces administrativ sipas ligjit nr. 49/2012. Gjatë kësaj kohe fëmijët mund të vijojnë të luajnë në zonat e tjera, siç ka ndodhur në Republikën e Shqipërisë që nga shpallja e pavarësisë më 1912 e deri më sot.

Së dyti, objektivi që Bashkia Tiranë ka vendosur për ta përuar këtë park më 1 Qershor 2016 nuk përbën ndonjë interes publik të rëndësishëm, mosrealizimi i të cilit të sjellë pasoja të rënda për interesin publik. Data 1 Qershor përmban një simbolikë të caktuar, por jo më shumë se kaq. Kjo datë nuk lidhet me ndonjë nevojë të veçantë praktike dhe jetike, por ka vetëm vlerë formale për ditën e përrurimit. Gjykata nuk duhet të ndikohet nga kjo datë e synuar, ndërkohë që vlera e dëmit të rëndë dhe të pariparueshëm kalon shumë herë në vlerë dhe në kohë simbolikën e një date përrurimi, e cila mund të zëvendësohet shumë mirë me ndonjë datë tjerë, si për shembull Dita Universale e Fëmijëve më 20 Nëntor, e rekomanduar nga OKB, apo Dita e Verës më 15 Mars, etj. Arritja e datës 1 Qershor nuk është e domosdoshme për interesin publik, por është më tepër një luks marrëdhëniesh publik, ndaj edhe nuk ekziston as nevoja apo domosdoshmëria për ta realizuar sa më shpejt kontratën.

Së treti, në balancën e interesit publik anon më shumë interesi për të mbrojtur Parkun e Tiranës. Padia e ngritur është një rast i veçantë. Ajo përbën një actio popularis dhe njihet nga legjislacioni ynë vetëm në rast të mbrojtjes së mjedisit. Është i vetmi rast kur edhe një anëtar i vetëm i publikut mund të ngrejë padi për interes të të gjithëve. Ky lloj legjitimitimi i veçantë ka një bazë të fortë logjike. Mandati i një autoriteti publik është i kufizuar, për shembull në rastin konkret është 4 vjet. Ndërkohë, ndërhyrjet në mjedis nuk kanë pasoja 4 vjeçare, por shumëvjeçare e mbase edhe permanente. Është shumë e rëndësishme që ne që jetojmë sot mbi këtë tokë të lëmë trashëgim një mjedis të përshtatshme për brezat e ardhshëm. Jemi të gjithë dëshmitarë se si natyra po degradohet çdo ditë nga ndërhyrjet e papërgjegjshme të njeriut për interesa ekonomike momentale. Pikërisht, që të mundësohet ndërhyrja gjyqësore ndaj këtyre veprimeve, ligji ka parashikuar mundësinë e çdokujt, që ka ndërgjejen e duhur në momentin e duhur, që të mbrojë jo vetëm copëzën e vet të mjedisit, por edhe atë të të tjerëve që jetojnë sot dhe që çdo ditë jetojnë nesër.

Interesi publik i Bashkisë Tiranë është të ndërtojë një park lojrash për fëmijë. Interesi publik i paditësve është të mbrojnë Parkun e Tiranës për të garantuar integritetin e mbetur të tij, për fëmijët, për të rriturit, për të moshuarit, apo edhe për ata fëmijë që mund të mos luajnë në atë park edhe për disa javë, por që ndoshta do ta gëzojë atë park kur të rriten dhe të plaken. Balanca është e qartë që anon nga ana e paditësve. Interesi publik, jo vetëm që nuk cenohet rëndë, por nuk cenohet as lehtë dhe madje mbrohet më shumë.

2. Marrja e masave të tjera të përshtatshme

Referuar nenit 30 të ligjit nr. 49/2012 nga gjykata kërkohet paralelisht marrja e të dyja

masave të sigurisë të renditura më sipër. Krahas pezullimit të zbatimit të akteve administrative, kërkohet edhe marrja e masave të tjera të përshtatshme, sic është pezullimi i zbatimit të kontratës mes Bashkisë Tiranë dhe kontraktorëve të saj për ndërtimin e parkut të lojrave. Kjo kërkesë bëhet pasi vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme. Pezullimi i lejes së ndërtimit nuk ndalon automatikisht dhe menjëherë kryerjen e veprimeve në zbatim të kontratës së sipërpërmendur. Për këtë arsye, gjykata duhet të pezullojë shprehimisht edhe këto veprime.

3. Praktika gjyqësore në lidhje me pezullimin e zbatimit të aktit administrativ

Sic është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 32 dt. 24.11.2003: *"E drejta e pezullimit të aktit, objekt shqyrtimi gjyqësor, është një e drejte që lidhet pazgjidhshmërisht me procesin e rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 të Kushtetutës... në parametrat që kërkon dispozita e mësipërme kushtetuese, ashtu dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Qendrimi pro pezullimit të akteve administrative shpesh gjën pranimin nga gjykata. Mund të sjellim në vëmendje çështje të ndryshme ilustruese si për shembull: Vendimi nr. 14241 akti, dt. 19.07.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 92, dt. 02.04.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimi nr. 11887 akti, dt. 26.07.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 176, dt. 15.02.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë.*

Bazuar në këto argumenta, paditësit dhe përfaqësuesi i tyre kërkuan pranimin e kërkesave për marrje mase sigurim padie dhe masave shtese të sigurimit të padisë.

Në lidhje me kërkimin për marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe masave shtese për sigurimin e padisë, përfaqësuesia e palës së paditur Bashkia Tiranë parashtroi këto prapësime:

Kërkimi i paditësave për marrjen e masës së sigurimit të padisë është i pabazuar në ligj dhe në prova, pasi:

Së pari, referuar nenit 28 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". i ndryshuar, sigurimi i padisë si instrument ligjor synon të rregullojë një situatë faktike që sjell një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm. i cili rrjedh nga ekzekutimi i një veprimi administrativ. *Dëmi duhet të jetë eventual, citojmë* ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi. Sqarojmë se punimet kanë filluar në zbatim të lejes së ndërtimit të datës 03.03.2016. Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhjen e datës 12.02.2016 ka marrë vendimin nr. 1 "Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin Këndi i Lojrave për Fëmijë, projekt pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të Liqenit", në përputhje me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Së dyti, përveç mbështetjes në nenin 28 të këtij ligji, kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të gjejë njëkohësisht mbështetje edhe në nenin 29 të këtij ligji, ku përcaktohen kushtet që duhet të plotësohen për t'u gjendur përpara kushteve të kërkimit të sigurimit të padisë. Ky nen bën fjalë për dëm të rëndë, të pariparueshëm dhe të atëçastshëm, tre kushte kumulative që duhet të plotësojë pretendimi apo kërkesa e

palës paditëse. Shprehemi se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm dhe i bazuar në prova shkresore se ndaj paditësit po shkaktohet një dëm i rëndë e i pariparueshëm, njëkohësisht dhe i atçastshëm. Theksojmë faktin se, leja e ndërtimit është miratuar në datën 03.03.2016, nga ky moment kanë nisur punimet nga Bashkia e Tiranës në kuadër të rehabilitimit të Parku të Liqenit. Pra, dëmi që pretendojnë paditësit nuk është i atçastshëm, pasi ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga data i marrjes së lejes dhe fillimit të punimeve deri në momentin që po flasim. Pala paditëse nuk rezulton të ketë paraqitur prova shkresore për të provuar dëmin e rëndë e të pariparueshëm që i vjen asaj dhe të gjitha pretendimet e ngritura në padi, për të argumentuar arsyet pse duhet marrë masa e sigurisë rezultojnë të paprovuara dhe të paqëna. Pretendimi për një dëm të rëndë dhe të pakthyeshëm duhet të personifikojë gjithashtu një dëm të atëçastshëm për kërkuesin, të prekshëm dhe jo hipotetik.

Në lidhje me pretendimin se gjatë zbatimit të projektit do të prihen shumë pemë. Paditësit nuk kanë sjellë asnjë provë shkresore. Ndryshe nga sa pretendon pala paditëse, pasojat rrjedhin nga një leje ndërtimi, e miratuar nga KKT, e cila i plotëson të gjitha kushtet. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon paditësi se punimet po zhvillohen pa marrë leje mjedisore, me shkresën nr. 1291/1, datë 01.03.2016, Ministria e Mjedisit ka kthyer përgjigje, duke konfirmuar se projekti "Kënd lojrash për fëmijë" nuk është i listuar në shtojcat I dhe II të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar. Pra në rastin konkret nuk ka nevojë për leje mjedisore.

Referuar shkresës nr. 390/01, datë 02.03.2016, me të cilën Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka kthyer përgjigje duke dhënë konfirmimetin për Parkun e Lodrave në Parkun e Liqenit, ka sqaruar gjithashtu se ky projekt është pjesë e masterplanit të hartuar për parkun, ndërmjet një procesi "Shërbim Konsulencë", realizuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Hartimi i projektit është ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me FSHZH mbi bazën e një akt-marrëveshje lidhur me datë 23.01.2015. Ndërkohë që Shërbimi i Konsulencës është kërkuar nga FSHZH për "Përgatitjen e Masterplanit të Parkut të Liqenit dhe 5 projekte pilot".

Masterplani për Parkun e Liqenit është konstatuar se i përgjigjet termave të referencës. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit thekson se konfirmimetin është dhënë përpara se projekti të hynte në procedurat e aplikimit për leje ndërtimi, për këtë arsye nuk ka qënë e nevojshme që të shprehej me vendimin e KKT-së kushti për marrjen e konfirmimit nga AKPT. Gjithashtu, gjykata nuk mund të vendosë miamjen e masës së sigurimit nëse çënohet rëndë interesi publik. Konkretisht, nëse do të merrej masa e sigurimit të padisë, do të çënohej interesi publik, pasi zbatimi i projektit ka si qëllim interesin publik. Kjo pronë figuron e regjistruar në emër të shtetit dhe përdoret për interes publik. Parku të Liqeni Artificial është një sipërfaqe trualli që shërben për përdorim të publikut të gjerë, në të cilin Bashkia Tiranë po zbaton plan rregullues rehabilitimi. Masa e sigurimit të padisë duhet të ketë lidhje me objektin në padinë e ngritur. Paditësit kanë kërkuar në padi pavlefshmërinë absolute të aktit, paligjshmërinë e punimeve dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë për të ndaluar punimet si dhe kthimin në gjendjen e mëparshme. Mbi këtë objekt nuk mund të kërkohet marrja e masës së sigurisë. Nuk mund të vendoset me ane të një mase të sigurimit të padisë urdherimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri.

nuk qëndron pasi:

Ministria e Mjedisit , me shkresë nr. 1291/1 prot, datë 01.03.2016 sqaron se : Projekti ' Lojra e për fëmijë, projekti pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të liqenit Bashkia Tiranë", nuk është i listuar në shtojzat I dhe II të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar.

Gjithashtu, ky pretendim nuk mund të merret parasysh se ka të bëjë me themelin e çështjes. Ky qëndrim bie në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 10, dt. 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Pra nuk kemi dyshim të arsyeshëm, të bazuar në shkresë për të marrë masën e sigurimit të padisë.

Në lidhje me dëmin e rëndë e të pakthyeshem, paditësi shprehet se: kemi dëmtime të interesave të riparueshme të mjedisit, kemi dëmtime të interesave të komunitetit, kemi dëmtime të interesave të cilësisë së jetës. Ky pretendim bie poshtë nga vetë paditësi që shprehet: Zona mund të kthehet në gjëndjen e mëparshme, por me kosto të larta për buxhetin e shteti e rrjedhimisht edhe interesin publik.Pra, vërtetohet që dëmi është i kthyeshem. Duke qënë se jemi tek koston, bazuar në nenin 29/c ligjit nr. 49/2012 kërkojmë që paditësi të japë garanci monetare. Kjo garanci është e nevojshme, pasi: Nëse pranohet sigurimi padisë, punimet do të ndalojnë dhe si rrjedhojë rrezikojnë që punimet të mos kryhen më pasi leja e ndërtimit e dates 03.03.2016, e vlefshme vetëm për 6 muaj nga momenti i lillimit të punimeve. Ndalesa e punimeve sjell gjithashtu dëmtim të materialeve të ndërtimit, si dhe pagesën e penaliteve ndaj firmës ndërtuese për shkak të zgjatjes së afatit të punimeve, duke përfshirë këtu pagesën e rrogës dhe sigurimeve shoqërore të punëtorëve.

Pra, paditësi në asnjë rast nuk ka përcaktuar cili interes është prekur dhe sa është vlera e dëmit që mund të vijë, si dhe përse dëmi është i pakthyeshem, i parikuperueshem. Paditësi nuk ka depozituar akte shkresore mbi vlerësimin e të cilave krijohet qartë dyshimi i arsyeshëm se mundësia për shkaktimin e një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëeastshëm për të është eventuale prej zbatimit të aktit administrativ. Paditësi nuk ka përcaktuar në terma realë sa është dëmi ekonomik i pretenduar si rezultat i zbatimit të aktit administrativ objekt gjykimi.

Në lidhje me dëmin e atëcastshëm, pretendojmë se dëmi që pretendon paditësi në rastin tonë nuk është i atëcastshëm, dhe i menjëhershëm. Paditësi shprehet se zona është betonizuar. Dëmi që pretendon paditësi. Punimet e ligjshme, bazuar në leje ndërtimi, tashmë kanë ndodhur dhe nuk jemi më përpara elementit të atëcastshëm apo i menjehershëm, që kërkon ligji. Mjafton vetëm ky fakt për të rrëzuar sigurimin e padisë.

Në lidhje me cënimin e rëndë të interesit publik, paditësi shprehet:

Akti administrative objekt gjykimi është abuziv. Akti administrativ objekt gjykimi ka dalë për interes publik, interes i cili do të dëmtohet nëse vendimi K.K.RR.T ka dalë në datë 12.02.2016, do të pezullohet nga gjykata. Vendimi KKT nr. 1, datë 12.02.2016 ka dalë në përputhje me kompetencat dhe procedurën e përcaktuar në ligj, në bazë të të cilave është i vetmi organ publik që përcakton se kemi interes publik në një territor të caktuar apo zona të rëndësisë kombëtare.

Bazuar në keto argumenta, avokati i shtetit kerkoi rrëzimin e kërkesës për sigurim padie si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Gjykata, duke pasur parasysh pretendimet, prapësimet dhe provat e marra deri në këtë moment si dhe parashikimet ligjore, çmon se ky kërkimi i paditësit për marrjen e masës së sigurimit të padisë është i pabazuar.

Neni 29 i ligjit nr. 49/ 2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" "Kushtet për sigurimin e padisë" parashikon: 'Gjykata vendos sigurimin e padisë nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin.
- b) Nuk cenohet rëndë rendi publik;
- c) Nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga siguri i padisë'.

Neni 30 i ligjit nr. 49/ 2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" 'Llojet e masave për sigurimin e padisë' parashikon: 'Sigurimi i padisë bëhet nëpërmjet:

- a) Pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ;
- b) Marrjen edhe të masave të tjera të përshtatshme nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme'.

Në rastin konkret, gjykata çmon se kërkimet për marrjen e një mase të tillë sigurimi padie dhe mase shtese sigurimi padie, janë të pabazuara, pasi:

Marrja e mases së sigurimit të padisë ka si qëllim të ruajë gjendjen juridike ekzistuese mes paleve, duke pezulluar ekzekutimin e veprimit administrativ që sjell ndryshime në këtë gjendje, apo marrjen edhe të masave të tjera të përshtatshme, nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme, deri në përfundim të shqyrtimit në themel të konfliktit mes paleve. Nga pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura deri në këtë moment nga paditësit nuk provohet ekzistenca e kushteve të parashikuara në nenin 29 të ligjit nr. 49/ 2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" sipërcituar për marrje mase sigurimi padie apo masa shtese. Më konkretisht, paditësit kërkuan të merret si masë sigurimi e padisë pezullimi i lejes së ndertimit datë 03.03.2016, për objektin "Kendi i lojcrave për fëmijë, projekti pilot 4, në kuader të rehabilitimit të parkut të liqenit", dhënë zhvilluesit Bashkia Tiranë dhe si masa shtese pezullimi i menjehershëm i punimeve dhe veprimeve të Bashkisë Tiranë dhe nënkontraktoreve të saj brenda zonës së rëndësishme Kombëtare, Kurora e Gjelber e Tiranës dhe perkatesisht, Zonen Kadastrale nr. 8280 me Nr.Pasurie 2/280,Nr. pasurie 2/283 (zona e ndertimit), për Projektin "Kendi i Lojcrave për fëmijë" të prokuruar nga Bashkia Tiranë. Shpjegimet e dhëna dhe tërësia e provave të paraqitura nuk i krijuan bindjen Gjykatës se është e nevojshme marrja e masave të tilla. Kjo pasi:

Së pari, në bindjen e gjykatës provat e paraqitura nuk përbejnë një bazë të mjaftueshme për të mbështetur dyshimet e paditësive se atyre do t'u vije një dëm i

rende, i atëçatshëm e mbi të gjitha i pariparueshëm. Neni 29 i ligjit 49/2012 bën fjalë për dëm të rëndë, të pariparueshëm dhe të atëçatshëm, pra për tre kushte që duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative. Pretendimi për një dëm të rëndë dhe të pakthyeshëm duhet të personifikojë gjithashtu një dëm të atëçatshëm për kërkuesin, të prekshëm dhe jo hipotetik. Me konkretisht paditesit pretenduan se nga ekzekutimi i akteve objekt gjykimi po vijne pasoja të rënda në mjedis të tilla si betonizimi i parkut, frenim i ujërave nëntokësorë drejt rrënjëve të pemëve, frenim të ujërave shkarkues të tokës drejt liqenit, humbje përfundimtare të pjesës së gjelbëruar etj. Për të provuar këto pretendime paditesit paraqiten si prova ne formen e kerkuar nga ligji vetëm aktet objekt gjykimi që kundërshtojnë. Nderkohe, për të provuar natyrën e punimeve, volumin e tyre, efektet në mjedis etj, dhe që lidhen pikërisht me demin e pretenduar, ata paraqiten disa fletëprintime (fotokopje), pra jo në formën e kerkuar nga ligji, të pamjeve të objektit që po ndërtohet në zbatim të akteve objekt gjykimi. Po kështu, në mbështetje të pretendimeve të tyre në lidhje me demin, paditesit paraqiten dhe një dokument shkresor, me lende "Vleresim i përgjithshëm i pasojave në mjedis nga ndërtimi i "Parkut të femijeve" brenda territorit të Parkut të Liqenit të Tiranës", realizuar me datë 10.05.2016 nga Prof. Sulejman Sulçe. Bashkelidhur këtij akti u paraqitën dhe nje fotokopje çertifikate nr. 331 prot, date 09.09.2004 për z. Sulejman Sulçe, në bazë të të cilit z. Sulçe është çertifikuar nga Ministri i Mjedisit të kohës (viti 2004) për hartimin e raporteve të vleresimit të ndikimit në mjedis. Pra, përveçse kjo çertifikate ishte jo në formën e kerkuar nga ligji, bashkelidhur aktit të vleresimit duhet të ishte paraqitur dokumenti që provon se z. Sulejman Sulçe aktualisht ushtron veprimtari vlersuese të ndikimit në mjedis, konform parashikimeve ligjore në fuqi. Nga analiza në teresi e këtyre provave Gjykata çmon nuk provohet natyra e demit të pretenduar dhe rrjedhimisht dhe kushtet që duhet të plotësojë, e konkretisht: të qenit i rëndë, i atëçatshëm dhe mbi të gjitha i pariparueshëm. Për më tepër, në lidhje me kriterin "atëçatshmeri" të demit të pretenduar, nga pohimet e palëve në proces, përfshirë dhe paditesit, rezulton që nuk bëhet fjalë për punime të filluara rishtazi, por ato kanë kohë që kanë filluar, madje janë drejt përfundimit. Nderkohë, argumentat e paditesave në lidhje me faktin se demit lidhet dhe me mosplotësimin nga palet e paditura, gjatë procedurës së nxjerrjes së akteve objekt gjykimi, të dokumentacionit të nevojshëm, pikërisht atij në lidhje me ndikimin në mjedis të punimeve për realizimin e objektit, ky është një argument, bazueshmëria e të cilit lidhet me shqyrtimin e çështjes në themel, çka nënkupton që vetëm hetimi i plote, i gjithanshëm dhe objektiv në themel të çështjes, në lidhje me aktet objekt gjykimi do të krijojë gjykates bindjen në lidhje me bazueshmërinë e tij, qëndrim ky që përputhet dhe me praktiken unifikuese sipas vendimit unifikues nr. 10, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Së dyti, në lidhje me kushtin tjetër ligjor për mosçenimin e interesit publik, Gjykata vlereson se si marrja e masës së sigurimit të padisë pezullimi i lejes së ndërtimit datë 03.03.2016, për objektin "Kendi i lojërave për femije, projekti pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të parkut të liqenit", dhënë zhvilluesit Bashkia Tiranë ashtu dhe marrja e masave shtese nepermjet pezullimit të menjehershëm të punimeve dhe veprimeve të Bashkisë Tiranë dhe nënkontraktoreve të saj, do të çënonte interesin publik, pasi vetë aktet objekt gjykimi (vendimi i KRRIT dhe leja e ndërtimit) dhe punimet që kryhen në

zbatim te tyre prekin një numër të konsiderueshëm individësh të komunitetit, sikurse janë fëmijët, duke qënë se objekti i tyre është ndërtimi i një Këndi Lojrash për Fëmijë.

Së treti, paditësit nuk shprehen gadishmerinë ne lidhje me mundesine e venies së ndonje garancie, në llojin dhe masën e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'u shkaktohet të paditurve nga marrja e mases se sigurimit te padise dhe masave shtese te sigurimit te padisë.

Në përfundim, duke pasur parasysh gjithë sa më sipër u citua, gjykata çmon se kërkimet paditesave jane te pabazuara në ligj dhe në prova, e si te tilla duhen refuzuar.

PER KETO ARSYE:

Bazuar në nenet 28, 29 dhe 32 të ligjit nr. 49/ 2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSA:

- Të refuzojë kërkesat paditësive Anxhela Hoxha, Artan Manushaqe, Andi Tepelena, Brizida Gjickondi, Ervin Goci, Eljan Tanini dhe Rezarta Çaushaj për marrjen e masës për sigurimin e padisë dhe marrjen e masave shtese per sigurimin e padisë, si të pabazuara në ligj në prova.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e shpalljes. Për palet e paditura në mungese, ky afat fillon nga e nesërmeja e njoftimit te vendimit.
- Vendimi t'u komunikohet palëve të paditura në mungesë.
- U shpall, në Tiranë, më 12.05.2016.

SEKRETARE

ANISA ZOTO



GJYQTARE

SELVIE GJOÇAJ



